



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 490, datë 20.10.2020

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË
NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E LARTË, PËR POZICIONET E LIRA NË
FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.242, NR.243
DHE NR.244, DATË 09.07.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Alban Toro,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020.
2. Vendimi nr. 325, datë 17.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS